

VENDIM
Nr.906, datë 19.12.2004

**PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT MBIKËQYRËS TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 64 të ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale përfitojnë, për çdo mbledhje, një shpërblim fiks prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh. Pavarësisht nga numri i mbledhjeve të zhvilluara, masa e shpërblimit, për çdo periudhë 3-mujore, nuk duhet të jetë më e madhe se 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për shërbime jashtë vendbanimit të tyre, u paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale përfitojnë, pa pagesë, kopje të Fletores Zyrtare dhe të botimeve të dispozitave ligjore, që lidhen me sistemin e drejtësisë e, në mënyrë të veçantë, me sistemin e burgjeve.

4. Shpenzimet për veprimtarinë e këtij komisioni të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të shtetit, të miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

5. Efektet Financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë në datën 1 janar 2005.

6. Vendimi nr.612, datë 17.11.2000 i Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me burgim”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano